

VENDIM
Nr. 305, datë 20.4.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 124, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË FONDIT TË SIGURIMIT
TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5 e nenit 23, të statutit të miratuar me vendimin nr. 124, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshon si më poshtë vijon:

“5. Drejtori i përgjithshëm, me miratimin e Këshillit Administrativ, investon në letra me vlerë të qeverisë shqiptare deri në 100 për qind të fondit rezervë. Interesat e lidhura me investimin e fondit rezervë transferohen në llogaritë e Fondit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama